



# DITARI MUJOR

PRILL 2022



## Nënshkruhet Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Universitetit të Trakia në Stara Zagora Bullgari dhe Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"

Nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit mes Universitetit të Trakia në Stara Zagora Bullgari dhe Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".

Marrëveshja ka në qendër të saj mobilitetin e personeveve akademike, studentëve si dhe bashkëorganizmin e aktiviteteve dhe sipërmarrjeve kërkimore shkencore me interes të përbashkët.

### Sondazhi Kombëtar i Studentëve 2022

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, ka organizur në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", sesionin informues mbi sondazhin përgatitur për studentët, të dhënat e të cilit do të shërbejnë për marrjen e vendimeve të rëndësishme në hartimin e politikave shtetërore në fushën e Arsimin të Lartë dhe kërkimit shkencor me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë në Arsimin e Lartë.

### Konferenca e Parë Ndërkombëtare Studentore



Në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", është zhvilluar Konferenca e Parë Shkencore Studentore me temë "Shkenca e hapur dhe ndërkombëtarizimi". Në fjalën e tij përshëndetëse, rektori Prof.dr. Skender Topi, theksoi projektet, aktivitetet, trajnimet që kanë në fokus studentin dhe zhvillimin e tij akademik. Në përfundim të konferencës, nuk munguan as certifikatat dhe çmime të ndryshme për punimet më të arrira. Iniciativa e kësaj konference vjen si rezultat i përvojave të ngjashme të studentëve pjesëmarrës në mobilitete të ndryshme jashtë vendit.

### Nënshkruhet Memorandum Mirëkuptimi midis Universitetit A.Xhuvani dhe Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup



Në ambientet e Rektoratit të Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup, u nënshkrua Memorandum mirëkuptimi me Universitetin publik të Elbasanit, që ka për qëllim vendosjen e themeleve të bashkëpunimit reciprok në interes të dy institucioneve. Në bazë të këtij memorandumi synohet bashkëpunimi i gjërë akademik, shkencor dhe kulturor, si dhe të përcaktohen fushat për kërkimin shkencor e akademik, ndërsa palët u morrën vesh të punojnë së bashku në të ardhmen, për të nxitur një kuadër bashkëpunimi me synimin për të fituar nga iniciativat dhe procedurat e punës së njëri-tjetrit.

### Industria e turizmit dhe profesionet e së ardhmes



Në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", është zhvilluar workshopi me temë "Industria e turizmit dhe profesionet e së ardhmes", prezantuar nga Znj. Adriana Dodbiba Kotherja, Drejtore e Departamentit të kontratave Elite Travel Group. Studentët u prezantuan me historikun, zhvillimin, arritjet, misionin dhe vizionin e agjencisë Elite Travel Group. Znj. Dodbiba në prezantimin e saj, u ndal dhe në mundësitë që ofron kjo kompani për studentët përmes intershipeve dhe trajnime profesionale.

### Panairi mbarëkombëtar i Librit Akademik dhe Shkencor



Për 3 ditë rradhazi Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", ishte pjesëmarrës në Panairin Mbarëkombëtar të Librit Akademik dhe Shkencor, organizuar në mjediset e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Akademikë dhe qytetarë të ndryshëm, u njohën nga afër me punime kërkimore të pedagogëve dhe studentëve të universitetit.